



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 528/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos regjistrimit të votave në Formularin e të Dhënave dhe Rezultateve të KQZ-së, për shkak të parregullsive në Qendrën e Votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 25.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e pa lejuar ankesa Anr.528/2021 e datës 24.02.2021, parashtruar nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me të cilën ka kërkuar që të Urdhërohet KQZ-ja, të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 2042A/18R dhe 2003A/10R në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

## A r s y e t i m

Me datë 24.02.2021, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr. 528/2021, e paraqitur nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilën pretendon se në vendvotimin 2042A/18R (Shkolla Fillore “Abdyl Frashëri”) dhe vendvotimin 2003A/10R (Shkolla e Mesme “11 Marsi”), në Komunën e Prizrenit, kanë ndodhur parregullsi tek numërimi i votave dhe regjistrimit të tyre në FRP dhe FRK. Parashtruesi i ankesës pretendon se në vendvotimin 2042A/18R kandidati më i votuar nga ky subjekt, Fikret Morina, ka marrë 43 vota, ndërsa për Partinë Demokratike Turke të Kosovës janë shënuar vetëm 32 vota. Po ashtu në vendvotimin 2003A/10R Partia Demokratike Turke e Kosovës ka marrë 25 vota, ndërsa votat e kandidatëve nga ky subjekt nuk janë shënuar fare. Më tutje kërkojnë nga PZAP-i që të trajtojë këto parregullsi dhe të korrigjohet gabimi në këto çështje.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

## **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimet e përmendura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Paneli duke u mbështetur në Rregulloren Nr.02/2015, përkatësisht neni 6.4, me të cilën përcaktohet se: *“ankesa të cilat janë të pa lejuar dhe të pas afatshme PZAP-i, i hudhë si të pa lejueshme”*, pra ankesa në këtë rast është e palejueshme për faktin se është paraqitur para afatit të paraparë ligjor.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6, paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.528/2021 më datën 25.02.2021**

**Kryesuese e Panelit**  
**Milena Đerić**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*